



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 424/26, Datë 03.04.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregulloren (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 147 të mbajtur më 23.03.2026, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohen programet e studimeve të Universitetit të Prishtinës - Fakulteti Filozofik për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 1. *Trashëgimi Kulturore, MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- II.** Riakreditohen programet e studimeve të Universitetit “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 2. *Antropologji dhe Trashëgimi Kulturore, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
 3. *Psikologji, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik.*
 4. *Psikologji Shkollore dhe Këshillim, MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik.*
 5. *Psikologji Klinike dhe Komuniteti, MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik.*
- III.** Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Universiteti “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Universiteti “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.

VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Trashëgimi Kulturore, MA (120 ECTS) A ;	Arsim Canolli Sedat Baraliu
2.	Antropologji dhe Trashëgimi Kulturore, BA (180 ECTS) R;	Zanita Halimi Tahir Latifi Arben Hajdari
3.	Psikologji, BA (180 ECTS) R;	Dashmir Bërxulli Liridona Jemini Gashi Kaltrina Kelmendi
4.	Psikologji Shkollore dhe Këshillim, MA (120 ECTS) R ;	Aliriza Arenliu Zamira Hyseni
5.	Psikologji Klinike dhe Komuniteti, MA (120 ECTS) R ;	Mytaher Haskuka Fitim Uka

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Trashëgimi Kulturore, MA (120 ECTS)* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më datë 20.01.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; *Antropologji dhe Trashëgimi Kulturor, BA (180 ECTS)* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 20.01.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.
3. Për programin e studimit; *Psikologji, BA (180 ECTS)* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 02.02.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht dy (2) fushë të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
 - Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
4. Për programin e studimit; *Psikologji Shkollore dhe Këshillim, MA (120 ECTS)* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 02.02.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
 - Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
5. Për programin e studimit; *Psikologji Klinike dhe Komuniteti, MA (120 ECTS)* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 03.02.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
 - Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 147-të, të mbajtur më datë 23.03.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Hasan Prishtina” Fakulteti Filozofik dhe duke u bazuar në raportet e ekipeve të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/1-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Hasan Prishtina” Fakulteti Filozofik;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë